



KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE

Datë: 14.05.2025

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (GZ Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1 dhe nenin 44, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 1, 49 dhe 136 të Rregullores për Shërbime Publike Komunale Nr. 28, të datës 06.02.2023, lëshon:

URDHËRESË

1. Për lirim të sipërfaqeve publike nga objektet e përkohshme në rrugën **“Amir Elmazi”** në Fushë-Kosovës.
2. Urdhërohen të gjithë personat fizik dhe juridik që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh kalendarike nga dita e shpalljes së kësaj urdhërese në faqen zyrtare të Komunës, t’i lirojnë sipërfaqet e cekura në pikën 1 të kësaj urdhërese.
3. Në raste të mosrespektimit të kësaj urdhërese Komuna e Fushë-Kosovës do të ndërmarrë masa ligjore për lirim të sipërfaqeve publike për realizimin e projektit **“Asfaltimi i rrugës Amir Elmazi”**, në bashkëpunim me Policinë e Republikës së Kosovës.
4. Të gjitha shpenzimet për lirim të sipërfaqeve publike të shfrytëzuara do të mbulohen nga personat përgjegjës që nuk e respektojnë këtë urdhëresë.
5. Personat që nuk e respektojnë këtë urdhëresë do të procedohen sipas dispozitave ligjore dhe ndaj tyre do të shqiptohen gjoba në përputhje me dispozitat e Rregullores për Shërbime Publike Komunale Nr. 28 të datës 06.02.2023 dhe dispozitat e ligjeve në fuqi.
6. Për zbatimin e kësaj Urdhërese kompetent është Drejtoria për Infrastrukturë dhe Drejtoria për Inspektorat.
7. Kjo Urdhëresë hyn në fuqi, ditën e shpalljes në faqen zyrtare të Komunës së Fushë-Kosovës.

